




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. 03-02/DPK	Br. Prot. 01-1524/16
Dep.	Prot. No.
Nr. lfaq.	Data
Broj stranica 03	Datum 22-04-2016
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	21.04.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPK 03-02-1347/16
PËR/ZA/TO:	z. Elhami Hajdari – Kryeshef Ekzekutiv në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik

I nderuari z. Hajdari,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, lidhur me kërkesën që keni bërë për sqarimin e situatës së konfliktit të mundshëm të interesit në rastin e konkurrimit për subvencione dhe grante për punonjësit e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe atyre të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, si dhe familjarëve të tyre, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Ekziston mos pajtueshmëri për zyrtarët e lartë publik në ushtrimin e funksioneve të tyre publike në rast të përfitimit të grandeve dhe ndihmave nga institucionet ku punojnë;

Për nëpunësit e tjerë nuk ka kufizime e as konflikt faktik të interesit në përfitimin e subvencioneve dhe grandeve, mirëpo në raste të caktuara mund të paraqitet konflikti “rast për rast” i interesit;

Agjencia jep rekomandimet e saj për rastet e shmangies së konfliktit “rast për rast” të interesit;

ARSYETIM

Nga dokumentacioni që i keni bashkangjitur kërkesës dhe nga takimi me zyrtarë të AZHB-së, kemi kuptuar se në Programi i Pagesave Direkte, në bazë të cilit ofrohen subvencione, është proces garues ndërsa, Programi i Zhvillimit Rural, në të cilin ofrohen grande nuk është proces garues. Ndërsa për vlerësimin e ndarjes së grandeve dhe subvencioneve ekzistojnë divizione të veçanta siç janë Divizioni i Miratimit të projekteve, Divizioni i Kontrollit dhe Divizioni i autorizimit të pagesave.

Lidhur me këtë situatë, ekziston një ndalim i natyrës “absolute” për zyrtarët e lartë që lidhet me funksionin e tyre. Ligji për Parandalimin e Konfliktit të interesit, në nenin 15 (pika 5), shprehimisht përcakton se:

“Ndërmarrja në të cilën zyrtari i lartë ka pronësi apo pjesë të pronësisë, e drejtuar nga personi i besuar, nuk ka të drejtë të lidhi kontratë ose të përfitoj ndihmë nga institucionet qendrore ose lokale, në të cilat zyrtari i lartë është në pozitë vendimmarrëse”.

Kjo do të thotë se zyrtarët e lartë publik janë të përjashtuar nga mundësia e lidhjes së kontratave në institucioneve në të cilat ushtrojnë funksionin. Në këtë rast, këta zyrtarë janë të përjashtuar nga marrja e ndihmës në institucionet ku punojnë.

Përveç kësaj, mundësia e shfaqjes së konfliktit “rast për rast” të interesit ekziston edhe për nëpunësit tjerë të cilët nuk janë zyrtarë të lartë publik. Kjo mundësi mund të shfaqet tek zyrtarët e këtyre divizioneve gjatë vlerësimit të projekteve për dhënien e grandeve, meqenëse ato kanë karakter garues.

Mirëpo konflikti “rast për rast” mund të parandalohet. Në rastin konkret, zyrtarët të cilët vlerësojnë dhënien e subvencioneve dhe grandeve të cilët kanë ndonjë interes personal për vete apo të afërmit e tyre, duhet të tërhiqen nga procesi i vlerësimit dhe vendimmarrjes dhe të zëvendësohen nga zyrtarë tjerë.

E gjithë kjo parashihet në dispozitat Ligjit për Shërbimin Civil në të cilat përcaktohet se: *“Nëpunësit civil nuk duhet të lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt interesi”.* (neni 5, pika 8 i Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil).

Meqenëse, Ministria e Bujqësisë dhe Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë nuk e kanë rregulluar me rregulla të brendshme konfliktin e interesit, Agjencia kundër Korrupsionit ju rekomandon që në këtë aspekt të hartoni akte nënligjore me të cilat e rregulloni këtë fushë. Kjo është e domosdoshme për faktin se kjo zbrazëti ligjore ndikon në uljen e besimit të konkurrentëve tjerë dhe qytetarëve në përgjithësi. Kjo aq më tepër se parandalimi i konfliktit të interesit do të thotë parandalim i korrupsionit në burim.

Prandaj, AKK është e gatshme për ofrimin e ndihmës profesionale për hartimin e këtyre akteve nënligjore, për parandalimin e konfliktit të interesave.

Me respekt!

